

NJOFTIMI I MODIFIKIMIT TË **KONTRATËS GJATË KOHËZGJATJES SË** **SAJ**

BASHKIA LIBOHOVË

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Bashkia Libohovë
Adresa Rruga “Avni Rustemi”, lagjia Linua, Libohovë
Tel/Faks 069 36 54 646 / 088122091
E-mail info@bashkialibohove.gov.al
Ueb-faqe www.bashkialibohove.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Kristaq Ciko
E-mail kristaqciko9@gmail.com

3. Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: Kontratë Publike për punë

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF- 66653-10-24-2025

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër : Shtrim me beton i rrugëve të brendshme në lagjen Baillo

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

Rërë 14211000-3
Beton 44114000-2
Punime ndërtimi 45210000-2

8. Fondi limit: 7,283,972

(shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:

Referuar nenit 47, pika 2 të ligjit nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i cili parashikon: “Shkronja “b” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“b) për furnizimin e mallrave, shërbimeve apo kryerjen e punëve në një kontratë që është ende në zbatim nga kontraktori fillestar, të cilat janë bërë të domosdoshme dhe nuk janë përfshirë në dokumentet e tenderit për kontratën fillestare dhe kur zëvendësimi i kontraktorit fillestar:

i. nuk është i mundur për arsye ekonomike apo teknike, sikurse janë kërkesat për zëvendësimin apo ndërveprimin me pajisjen, shërbimet apo instalimet ekzistuese, të prokuruarat gjatë procedurës fillestare; si dhe

ii. do të shkaktonte vështirësi të mëdha apo rritje të konsiderueshme të kostove për autoritetin kontraktor.

Në këtë rast, dokumentimi i modifikimeve duhet të përmbajë një argumentim të të gjitha arsyeve se përse furnizimet, shërbimet ose punët janë të domosdoshme, arsyet përse ato nuk janë mbuluar nga kontrata fillestare apo marrëveshja kuadër, si dhe arsyet ekonomike dhe teknike prej të cilave nuk mund të zëvendësohet kontraktuesi fillestar.”.

Mbështetur në sa u tha më sipër, në përputhje me detyrimin ligjor për të dokumentuar modifikimet dhe njëkohësisht për t'i argumentura ato, më poshtë do të paraqesim një analizë që përlligj modifikimin e kontratës, konform përcaktimeve të nenit 127, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të përditësuar.

Lidhur me argumentimin e arsyeve pse punët nuk janë mbuluar nga kontrata fillestare:

Referuar Procesverbalit për justifikimin e punimeve të paparashikuara me nr.1905/27 Prot. datë 25.03.2026, përcaktohet shprehimisht se “ gjatë realizimit të punimeve sipas kontratës së lidhur më datë 09.12.2025, janë konstatuar ndryshime të domosdoshme në preventivin fillestar, të cilat lidhen me:

- Punime të paparashikuara që nuk ishin parashikuar në preventivin fillestar (gërmime, mbushje, shtresa, nënshtresa rrugore, betonarme shtesë).
- Pasaktësi të zërave të preventivit (Beton C-25/30-prodhim materiali) që nuk përfshin furnizim-vendosjen.
- Nevoja për rishpërndarje të volumeve për përputhje me kushtet reale të terrenit dhe standardet e projektit”.

Lidhur me argumentimin e arsyeve pse punët janë të domosdoshme:

Referuar Procesverbalit për justifikimin e punimeve të paparashikuara me nr 1905/27 Prot. datë 25.03.2026, përcaktohet shprehimisht se “këto punime janë të domosdoshme për:

- Përfundimin e segmentit rrugor të parashikuar në projekt
- Sigurimin e qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit të rrugëve
- Përputhshmërinë me standardet teknike të projektit dhe legjislacionin në fuqi”

Lidhur me argumentimin e arsyeve ekonomike dhe teknike pse kontraktori fillestar nuk mund të zëvendësohet:

Bazuar në përcaktimet e nenit 127 , pika 1, gërma “b” e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, e cila është baza ligjore që motivon këtë amendim kontrate, do të paraqesim një analizë të arsyeve ekonomike dhe teknike pse kontraktuesi fillestar nuk mund të zëvendësohet, në përputhje me atë çka vetë ligji ka vendosur dhe konkretisht “kur zëvendësimi i kontraktorit fillestar: i. nuk është i mundur për arsye ekonomike apo teknike, sikurse janë kërkesat për zëvendësimin apo ndërveprimin

me pajisjen, shërbimet apo instalimet ekzistuese, të prokuruar gjatë procedurës fillestare; si dhe ii. do të shkaktonte vështirësi të mëdha apo rritje të konsiderueshme të kostove për autoritetin kontraktor”.

Referuar sa më lart, në bazë edhe të situatës faktike të konstatuar në terren, është i pamundur zëvendësimi i kontraktorit fillestar, qoftë për arsye teknike që lidhen me volumin e madh të punimeve që janë kryer prej tij, por edhe për arsye të karakterit ekonomik, duke marrë parasysh faktin se Bashkia Libohovë është një njësi e vetqeverisjes vendore, relativisht e vogël, me një buxhet të pamjfatueshëm për të mundësuar zëvendësimin e kontraktorit fillestar. Këto arsye do ta vendosnin Autoritetin Kontraktor përpara vështirësive të mëdha dhe rritjes së kostove, çka do të sillte si pasojë mospërfundimin e procedurës së prokurimit, e cila tashmë është në zbatim.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve

Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi kanë rënë dakord që të amendojnë nenin 5 të kontratës për punë publike me nr 1905/10 Prot., datë 09.12.2025 me objekt “Shtrim me beton i rrugëve të brendshme në lagjen Baillo të lidhur mes tyre, që trajton “Vlerën e kontratës”, duke e shtuar atë me 895,567 (tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose 1,074,680 (një milion e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë me TVSH, duke u bazuar në Procesverbalin me nr.1905/27 Prot. datë 25.03.2026 të Sipërmarrësit të Punimeve, në kërkesën për shtesë fondi nr.1905/24 Prot. datë 25.03.2026 të Mbikeqyrësit të Punimeve, si dhe në Preventivin e punimeve të paparashikuara.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/Marrëveshjes Kuadër:

5,692,180 (pesë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH ose 6,830,616 (gjashtë milion e tetëqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë me TVSH

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti):

6,587,747 (gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH, ose 7,905,296 (shtatë milion e nëntëqind e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë me TVSH

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër:

Në kontratën për punë publike me nr.1905/10 Prot., datë 09.12.2025, me objekt “Shtrim me beton i rrugëve të brendshme në lagjen Baillo”, palët në nenin 6 kanë përcaktuar se: “Afati i përfundimit të punimeve është sipas përcaktimeve të bëra në DST; 2 (dy) muaj nga data e fillimit të punimeve”, ndërsa në nenin 7 kanë përcaktuar se “Kjo kontratë bëhet efektive, me datën e nënshkrimit të saj prej palëve, por përlllogaritja e afatave fillon nga data e fillimit të punimeve prej Kontraktuesit”.

Dhe afati i ri (nëse është rasti):

Afati fillestar i kontratës është amenduar në bazë të amendimit me nr.1905/23 Prot., datë 23.02.2026, në të cilën Autoriteti Kontraktor (Bashkia Libohovë) dhe Kontraktuesi (Eurobeton shpk) kanë parashikuar si vijon: “Me vullnetin e tyre të lirë si dhe në respektim të parashikimit që bën neni 127, pika 1, gërma “c” e ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe konkretisht “kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër”, palët e mësipërme bien dakord që të amendojnë nenin 7 të kontratës fillestare për punë publike të lidhur mes tyre, që parashikon ‘data e përfundimit të punimeve’, duke zgjatur me 60 (gjashtëdhjetë)

ditë afatin për përfundimin e tyre, i cili ishte parashikuar fillimisht “afati i përfundimit të punimeve është sipas përcaktimeve të bëra në DST; (dy) muaj nga data e fillimit të punimeve” dhe duke e zgjatur këtë afat edhe me 60 (gjashtëdhjetë) ditë.

Njoftimi i fillimit të punimeve nga Sipërmarrësi i Punimeve është kryer nëpërmjet shkresës me nr.1905/14 Prot., datë 23.12.2025, ndërkohë që nga Mbikëqyrësi është kryer në po të njëjtën datë, nëpërmjet shkresës me nr.1905/13 Prot. Këto njoftime janë miratuar nga Autoriteti Kontraktor nëpërmjet procesverbalit me nr.1905/15 Prot., datë 23.12.2025.

Ky amendim i afatit kryhet duke marrë për bazë kërkesën me nr.1905/21 Prot., datë 23.02.2026 të Sipërmarrësit të punimeve “Eurobeton” shpk dhe kërkesën me nr.1905/22 Prot., datë 23.02.2026 të Mbikëqyrësit të Punimeve “Ozar Consulting” shpk në të cilat ata kanë kërkuar si vijon: “Nisur nga rrethanat dhe kushtet e ndodhura ku afati për realizimin e kësaj kontrate është 2 (dy) muaj, nga njoftimi i fillimit të punimeve njoftojmë se sasia e dendur e rreshjeve ka bërë të pamundur vazhdimin e punimeve. Ditët me shi janë të pasqyruara në ditarin e objektit dhe prania e rrjedhës së ujit në vendin ku do ndërtohet ura e bën të pamundur vazhdimin e punimeve”, ndërkohë që Mbikëqyrësi i punimeve “Ozar Consulting” shpk ka kërkuar: “Nisur nga rreshjet e vazhdueshme në këto data të cilat janë mbajtur edhe të pasyruara në ditarin e objektit nga drejtuesi i kantierit është bërë ndërprerja e punimeve për arsye sepse lloji i punimeve është në terren dhe është e pamundur për të punuar. Gjithashtu, ndërtimi i urës kërkon një kohë të caktuar për të ikur prania e ujit për arsye sepse vendi ku do të ndërtohet ura ka një rrjedhë të madhe uji. Nisur nga këto kushte kërkohet shtyrja e punimeve prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh për të bërë të mundur realizimin e punimeve sipas kontratës”.

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomik/ë:

Emri: EUROBETON SHPK

NIPT: K23116602P

Adresa: GJIROKASTËR, Ndanë rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavie, përballe Varrezave të qytetit Gjirokastër, godinë 2-kateëhe, nr. pasurie 19/5, Zona Kadastrale 8543

Kontaktet: Emri Tregtar: EUROBETON E-Mail: robertlulo@yahoo.com Telefon: 0692076412

15. Data e nënshkrimit të modifikimit :

- Amendim kontratë për punë publike nr.1905/23 Prot. datë 23.02.2026, nëpërmjet së cilës palët e mësipërme bien dakord që të amendojnë nenin 7 të kontratës fillestare për punë publike të lidhur mes tyre, që parashikon ‘data e përfundimit të punimeve’, duke zgjatur me 60 (gjashtëdhjetë) ditë afatin për përfundimin e tyre, i cili ishte parashikuar fillimisht “afati i përfundimit të punimeve është sipas përcaktimeve të bëra në DST; (dy) muaj nga data e fillimit të punimeve” dhe duke e zgjatur këtë afat edhe me 60 (gjashtëdhjetë) ditë.
- Amendim kontrate nr.1905/28, datë 27.03.2026, nëpërmjet së cilës Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi kanë rënë dakord që të amendojnë nenin 5 të kontratës për punë publike me nr 1905/10 Prot., datë 09.12.2025 me objekt “Shttrim me beton i rrugëve të brendshme në lagjen Baillo të lidhur mes tyre, që trajton “Vlerën e kontratës”, duke e shtuar atë me 895,567 (tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe 1,074,680 (një milion e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë me TVSH, duke u bazuar Procesverbalin me nr.1905/27 Prot. datë 25.03.2026 të Sipërmarrësit të Punimeve, në kërkesën për shtesë fondi nr.1905/24 Prot. datë 25.03.2026 të Mbikëqyrësit të Punimeve, si dhe në Preventivin e punimeve të paparashikuara.

16. Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë Libohovë

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti kontraktor:

Autoriteti Kontraktor Bashkia Libohovë ka lidhur kontratën për punë publike me nr. 1905/10 Prot., datë 09.12.2025 me operatorin ekonomik “EUROBETON” me objekt “Shtrim me beton i rrugëve të brendshme në lagjen Baillo”.

Afati fillestar për përfundimin e punimeve ka qenë “2 muaj nga data e fillimit të punimeve”, bazuar në DST dhe në kontratën për punë publike. Bazuar në procesverbalin për fillimin e punimeve me nr. 1905/15 Prot. datë 23.12.2025, rezulton se punimet kanë filluar në po këtë datë.

Palët nëpërmjet amendimit me nr. 1905/23, datë 23.02.2026, kanë rënë dakord të amendojnë nenin 7 të kontratës për punë publike të lidhur mes tyre, që parashikon “data e përfundimit të punimeve”, duke zgjatur me 60 (gjashtëdhjetë) ditë afatin për përfundimin e tyre, i cili ishte parashikuar fillimisht “afati i përfundimit të punimeve është sipas përcaktimeve të bëra në DST; (dy) muaj nga data e fillimit të punimeve” dhe duke e zgjatur këtë afat edhe me 60 (gjashtëdhjetë) ditë. Ky amendim i afatit kryhet duke marrë për bazë kërkesën me nr.1905/21 Prot., datë 23.02.2026 të Sipërmarrësit të punimeve “Eurobeton” shpk dhe kërkesën me nr.1905/22 Prot., datë 23.02.2026 të Mbikëqyrësit të punimeve “Ozar Consulting” shpk” në të cilat ata kanë kërkuar si vijon: Sipërmarrësi i punimeve “Eurobeton” shpk ka kërkuar “Nisur nga rrethanat dhe kushtet e ndodhura ku afati për realizimin e kësaj kontrate është 2 (dy) muaj, nga njoftimi i fillimit të punimeve njoftojmë se sasia e dëndur e rreshjeve ka bërë të pamundur vazhdimin e punimeve. Ditët me shi janë të pasyruara në ditarin e objektit dhe prania e rrjedhës së ujit në vendin ku do ndërtohet ura e bën të pamundur vazhdimin e punimeve”, ndërkohë që Mbikëqyrësi i punimeve “Ozar Consulting” shpk ka kërkuar: “Nisur nga rreshjet e vazhdueshme në këto data të cilat janë mbajtur edhe të pasqyruara në ditarin e objektit nga drejtuesi i kantierit është bërë ndërprerja e punimeve për arsye sepse lloji i punimeve është në terren dhe është e pamundur për të punuar. Gjithashtu, ndërtimi i urës kërkon një kohë të caktuar për të ikur prania e ujit për arsye sepse vendi ku do të ndërtohet ura ka një rrjedhë të madhe uji. Nisur nga këto kushte kërkohet shtyrja e punimeve prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh për të bërë të mundur realizimin e punimeve sipas kontratës”.

Autoriteti Kontraktor Bashkia Libohovë dhe sipërmarrësi i punimeve “EUROBETON” shpk, duke marrë në konsideratë faktin se rreshjet e shiut, të cilat u bënë shkak për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, kanë pasur ndikim negativ edhe në mbarëvajtjen e punëve të kryera, sepse nga kushtet e rënduara atmosferike janë krijuar problematika në trupin e rrugëve, të tilla si rrëshkitja apo krijimi i kanaleve nga rrëket e shiut, është vlerësuar e nevojshme që të shtohet fondi për të mundur përfundimin e punimeve, me cilësinë e nevojshme.

Lidhur me sa më lart, palët e mësipërme, nëpërmjet amendimit me nr. 1905/28, datë 27.03.2026, kanë rënë dakord që brenda afatit të vlefshmërisë së kontratës të shtojnë vlerën e kontratës si vijon: Me vullnetin e tyre të lirë si dhe në respektim të parashikimit që bën neni 127, pika 1, gërma “b” e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe konkretisht “Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet e mëposhtme; b) për furnizimin e mallrave, shërbimeve, apo kryerjen e punëve në një kontratë që është ende në zbatim nga kontraktori fillestar, të cilat janë bërë të domosdoshme dhe nuk janë përfshirë në dokumentet e tenderit për kontratën fillestare dhe kur zëvendësimi i kontraktorit fillestar: i. nuk është i mundur për arsye ekonomike apo teknike, sikurse janë kërkesat për zëvendësimin apo ndërveprimin me pajisjen, shërbimet apo instalimet ekzistuese, të prokuruar gjatë procedurës fillestare; si dhe ii. do të shkaktonte vështirësi të mëdha apo rritje të konsiderueshme të kostove për autoritetin kontraktor”, palët e mësipërme bien dakord që të amendojnë nenin 5 të kontratës për punë publike të lidhur mes tyre, që trajton “Vlerën e kontratës”, duke e shtuar atë me 895,567 (tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe 1,074,680 (një milion e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë me TVSH duke u bazuar në Procesverbalin me nr.1905/27 Prot. datë 25.03.2026 të Sipërmarrësit të Punimeve, në kërkesën për shtesë fondi

nr.1905/24 Prot. datë 25.03.2026 të Mbikeqyrësit të Punimeve, si dhe në Preventivin e punimeve të paparashikuara.